



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:124743

Datë: 19.03.2021

Numri i dokumentit: 01612314

**C.nr. 41/2017**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë civile e shkallës së parë**, me gjyqtaren Kaltrinë Haliti dhe bashkëpunatoren profesionale Gentiana Shabani, në çështjen kontestimore të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.”KEK”, sipas autorizimit nr. 229 të datës 21.06.2013 – Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektike Sh.A., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson J. M i nga Prishtina, e paraqitur ndaj të paditurit R. R nga Gjilani, rr.”...”, nr. 108, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Shabi Isufi nga Gjilani, me objekt kontesti, kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 299.28 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e palëve ndërgjyqëse më datën 23.02.2021 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.”KEK”, sipas autorizimit nr. 229 të datës 21.06.2013 – Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektike Sh.A., e paraqitur ndaj të paditurit R. R nga Gjilani dhe **DETYROHET** i padituri që paditëses të i paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej **299.28 €** (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e njëzet e tetë cent), me kamatë ligjore për mjetet e afatizuara për një vit ashtu siç paguajnë bankat e Kosovës, duke filluar nga data 30.12.2016, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

## **A r s y e t i m**

Paditësja pranë kësaj gjykate më dt. 30.12.2016, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material ndaj të paditurit R. R nga Gjilani.

Pas pranimit të padisë gjykata duke vepruar konform nenit 394 dhe 395 të LPK-së të paditurit ia ka dërguar aktvendimin për detyrimin e tij për tu përgjigjur në padinë e paditësit. Me dt.13.11.2020 gjykata ka pranuar përgjigjen nga ana e të paditurit, ku i ka theksuar se pretendimet e paditëses janë të pabazuara me arsyetimin se i padituri nuk ka kryer asnjë veprim të paraqitur në padi, se Akgjykimi Penal me të cilin është dënuar në shumën prej 200 € i njëjti është bërë i plotfuqishëm pa u njoftuar fare i padituri, si dhe ka theksuar se i padituri është paditur pa të drejtë nga fakti se që nga viti 2005, nuk ka punuar e as vepruar në lokacionin e përmendur. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses t'a refuzoj si të pabazuar dhe të pas afatshme përshkak të parashkrimit.

Në seancën gjyqësore të mbajtur më dt.23.02.2021, i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetet pranë propozimit për ekzekutimin, tani të konsideruar padi, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave t'a aprovoj në tërësi të njëjten si të bazuar.

Përfaqësuesi i të paditurit si në shqyrtimin përgatitor, kryesor, ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare, ka theksuar se nga provat e prezentuara kësaj gjykate, deklarimi i të paditurit në cilësi të palës, është vërtetuar se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, kjo për faktin se pretendimet e paditëses janë të pabazë, me arsyetimin se kërkesëpadia nuk mund të bazohet në Akgjykimin Penal sepse aktgjykimi penal është marrë me kërkesën e Prokurorisë Komunale dhe është lëshuar urdhëri ndëshkimor të cilin i padituri kurrë nuk e ka pranuar, sepse adresa e të paditurit ka qenë lokali afarist në "... në Gjilan, ndërsa i padituri jeton në rrugën "... Poashtu, ka shtuar se gjykata për të vërtetuar këtë fakt mund të vërtetohet edhe me procesverbalin kur është bërë ndërrimi i njehsorit që vërteton se në momentin e ndërrimit i padituri nuk ka qenë prezent që të vërtetohet se nuk ka pranuar e as vepruar në lokalin afarist në cilësinë e zdruktarisë, ku ka qenë i vendosur njehsori për të cilin pretendohet. Ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit në shumën prej 299.28 €, ka deklaruar se i njëjti nuk është shkaktuar nga i padituri sepse që nga viti 2005 kur është marrë njehsori elektrik nga e paditura, i padituri nuk e ka shfrytëzuar këtë njehsor dhe nuk ka shkaktuar kurrfarë shpenzimi. Tutje ka potencuar se kemi të bëjmë me kërkesëpadinë e parashkruar konform nenit 360 të LMD-ës, duke kërkuar kështu nga gjykata i që kërkesëpadinë e paditëses t'a refuzoj si të pabazuar në ligj dhe t'a obligoj paditësen në barjten e shpenzimeve të procedurës edhe atë në shumë prej 104 € për përgjigjen në padi dhe 2 seanca të mbajtura shumën prej 270 € sipas TA.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje civilo - juridike, në shqyrtimin kryesor të mbajtur më dt. 23.02.2021, gjykata bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave edhe atë: Aktgjykimin Penal me nr. P.nr. ...i dt. 09.11.2012; Transaksioni i konsumatorit i dt. 01.01.2012-31.12.2016, me DGL – ...; Transaksioni i konsumatorit i datës 26.07.2017; Procesverbali me nr. ... i përpiluar te konsumatori R. R – i nënshkruar nga A. I; Transaksioni i konsumatorit i dt. 11.12.2020; Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve nga ATK e dt. 22.02.2021.

Në seancën gjyqësore të mbajtur më datën 23.02.2021, gjykata ka dëgjuar në cilësi të palës të paditurin R. R, i cili në mes tjerash ka deklaruar se: prej vitit 2000 deri në fund të vitit 2005, ka punuar në atë punëtori, ndërsa në muajin 11 të vitit 2005 i është marr njëhori elektrik dhe që nga ajo kohë nuk ka punuar më në atë punëtori. Sa i përket puntorisë-firmës ku ka punuar, ka deklaruar se fillimisht forma e ka pasur emrin “...”, ndërsa më pas ia ka ndërruar emrin firmës në “...” dhe se që nga viti 2006 është larguar nga ai lokal dhe ka qëndruar në lokacione tjera. Ndërsa lidhur me dënimin në procedurë penale, i njëjti ka deklaruar se nuk ka qenë fare i njoftuar se është dënuar në procedurë penale, se policia e ka njoftuar se ka borxh ndaj KEK-ut dhe se e ka paguar dënimin për veprën penale për të cilën ishte dënuar nga Gjykata Komunale në Gjilan.

**Pas vlerësimit të provave të administruara, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:** se i padituri prej datës së pavërtetuar e deri më datën 30.04.2012, në shtëpinë e tij me qëllim që vetit t’i sjellë pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, duke keqpërdorur njëhori elektrik ashtuqë paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 299.28 €.

Nga Transaksioni i konsumatorit i dt. 01.01.2012-31.12.2016, me DGL – ... në emër lokal të R. R, gjykata vërtetoi faktin se dëmi që i është shkaktuar paditëses është në shumën prej 299.28 €.

Po ashtu nga Transaksioni i konsumatorit i datës 26.07.2017, gjykata vërtetoi faktin se borxhi kryesor-i përgjithshëm sipas kësaj fature është 1,813.31 € në emër të lokal R. R, por se edhe nga ky transaksion gjykata vërtetoi faktin se dëmi që i është shkaktuar paditëses nga i padituri për të cilin edhe paditësja kërkon kompensimin e dëmit material është në shumën prej 299.28 €.

Me Aktgjykimin Penal me nr. P.nr. ...i dt. 09.11.2012, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri R. R nga Gjilani është shpallur fajtor për veprën penale Vjedhja nga neni 252 par. 1 të KPK-së dhe është dënuar me urdhër ndëshkimor në shumën prej 200 €, kurse pala e dëmtuar përkatësisht paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike është urdhëruar në kontest të rregullt civil.

Nga Procesverbali me nr. .... i përpiluar te konsumatori R. R – i nënshkruar nga A. I i, gjykata vërtetoi se sektori i kalibrimit i Kek-ut më dt. 30.04.2012 ka përpiluar procesverbal të kontrollit detal të njëhori elektrik nr. ...., nga i cili procesverbal emri i konsumatorit është shkruar R. R, emërtimi i veprimtarisë komerciale Lokal ..., ndërsa punëtorët e KEK-ut kanë konstatuar se

konsumatori e ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, mirëpo njehsori i vjetër ka munguar në momentin e kontrollimit.

Duke u bazuar në faktin se kontrata për shërbimet është kontratë e dyanshme ngarkuese, respektivisht krijon të drejta dhe detyrime për të dy palët, e që paditësja në tërësi e ka përmbushur detyrimin e saj duke i ofruar shërbime të energjisë elektrike të padituri, atëherë rrjedh edhe detyrimi i të paditurit që të shpërbleje paditësen me pagesën e këtyre shërbimeve si kundër shpërblim. Këtë detyrim e ka përcaktuar shprehimisht neni 262 i LMD/Ligji i vitit 1978 që ka qenë në fuqi në kohën e themelimit të raportit civil në të cilën nen thuhet se ***“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkoj mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë t’ia mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”***.

Prandaj, duke u bazuar në gjendjen faktike të përshkruar si më lartë, gjykata e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar në ligj duke e detyruar të paditurin, që paditëses t’ia paguaj borxhin në shumë prej **299.28 €** (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e njëzet e tetë cent), në emër të kompensimit të dëmit material, lidhur me shpenzimet e energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar, për periudhën kohore nga data e pavërtetuar e deri më datën 30.04.2012, andaj, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pretendimet e të paditurit se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me parashkrim, gjykata konstaton se në rastin konkret duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 377 të LMD-ës së vjetër, me të cilin parashihet se ***“Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”***, prandaj duke u bazuar nga të lartcekurat vijmë në përfundim se nuk kemi të bëjmë me parashkrim ashtu siç pretendon pala e paditur, pasi që bazuar nga Aktgjykimi penal i kësaj gjykate i datës 09.11.2012 me nr. P.nr. ..., i cili vendim është bërë i plotfuqishëm më dt. 16.01.2014, ndërsa padinë pala paditëse e ka paraqitur në këtë gjykatë më datën 30.12.2016, shihet se nuk ka kaluar afati i parashkrimit i paraparë me dispozitat ligjore të KPK-ës, pasi që vepra penale për të cilën është shpallur fajtor tani i padituri R. R sipas nenit 252 të Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës, e i cili ka paraparë që për veprën e tillë penale për të cilën është dënuar i padituri, citohet si në vijim ***“Kushdo që tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet”***, prandaj edhe gjykata konsideron se nuk kemi parashkrim të kërkesës së palës paditëse dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur që secila nga palët t’ia bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 4 të LPK-ës.

Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar në nenin, si dhe nenit 142 pika 1 dhe 2 të LPK-se, dhe nenit 262 dhe nenit 377 të LMD-ës vjetër, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr. 41/2017, të dt. 23.02.2021**

**Gjyqtarja,**  
Kaltrinë Haliti

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të vendimit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.